

Njoftim për përqendrim me të cilin KF FINANS, shoqëri për vlerësime dhe këshillim financiar, sh.p.k., Slloveni dhe z-nj. Miroslava Pirc, Slloveni do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi ZA & SVET ndërmjetësim në sigurime sh.p.k., Slloveni

(lënda nr. 08-27/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më 29.01.2025, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, ka pranuar një njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të përbashkët nga KF FINANS, shoqëri për vlerësime dhe këshillim financiar, sh.p.k., me seli të regjistruar në adresën Verovshkova ulica 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni dhe z-nj. Miroslava Pirc, shtetase e Republikës së Sllovenisë, mbi shoqërinë tregtare ZA & SVET ndërmjetësim në sigurime sh.p.k., me seli të regjistruar në adresën Amerishka ulica 2, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë, përmes fitimit të kontrollit të pavarur nga KF FINANS mbi shoqërinë tregtare INSURE Invest, shoqëri për investime sh.p.k., me seli të regjistruar në adresën Vrh pri Fari 12, 1336 Kostel, Republika e Sllovenisë, e cila zotëron 50% të pjesëve në ZA & SVET ndërmjetësim në sigurime sh.p.k. Pjesët e mbetura 50% të ZA & SVET ndërmjetësim në sigurime sh.p.k. janë në pronësi të z-nj. Pirc.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

KF FINANS, shoqëri për vlerësime dhe këshillim financiar, sh.p.k., është një shoqëri sllovene e specializuar në vlerësime dhe këshillim financiar, me veprimtari prioritare të regjistruar – aktivitete këshilluese në lidhje me menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm (kodi i veprimtarisë: 7022). KF FINANS, shoqëri për vlerësime dhe këshillim financiar, sh.p.k., është pjesë e Grupit ALFI.

Grupi ALFI është aktiv kryesisht në menaxhimin e investimeve dhe pronave, veçanërisht në fushat e shitjes me pakicë, mbledhjes së borxheve dhe investimeve alternative. Grupi analizon investimet (potenciale) dhe menaxhon fondet e investimeve, ndërsa menaxhimi i investimeve i është besuar pjesërisht shoqërive të tjera brenda grupit. Megjithatë, Grupi ALFI aktualisht nuk ka investime apo aktivitete afariste në fushën e ndërmjetësimit në sigurime në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në kuptimin më të gjerë, Grupi ALFI ka një prani lokale të regjistruar përmes një shoqërie të varur në mënyrë indirekte dhe realizon të ardhura në Maqedoninë e Veriut përmes tregtisë me shumicë të lodrave, pajisjeve cilësore për fëmijë, aksesorëve për fëmijë dhe tekstileve për fëmijë.

Z-nj. Pirc është shtetase e Republikës së Sllovenisë dhe një nga themelueset e ZA & SVET ndërmjetësim në sigurime sh.p.k.

Z-nj. Pirc është pronare e 50% të pjesëve në kapitalin themelor të ZA & SVET ndërmjetësim në sigurime sh.p.k., ndërsa shoqëria INSURE Invest, shoqëri për investime sh.p.k., zotëron 50% të mbetura të pjesëve, duke e bërë kështu z-nj. Pirc dhe INSURE Invest bashkëpronarë dhe bashkë kontrollues të ZA & SVET ndërmjetësim në sigurime sh.p.k.

Asnjë shoqëri në të cilën z-nj. Pirc ka pjesëmarrje nuk ka një shoqëri të varur të regjistruar, nuk kryen aktivitete afariste dhe nuk realizon të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

ZA & SVET ndërmjetësim në sigurime sh.p.k. është një shoqëri sllovene për ndërmjetësim në sigurime e themeluar në vitin 2003.

ZA & SVET ofron shërbime të plota të ndërmjetësimit në sigurime dhe menaxhimit të rrezikut për subjektet juridike, duke krijuar programe sigurimi të personalizuar bazuar në analiza të detajuara të rreziqeve, nevojave dhe kërkesave të klientëve. ZA & SVET ndërmjetësim në sigurime sh.p.k. është një ndërmjetës i pavarur në sigurime dhe bashkëpunon me shoqëri sigurimi dhe ri sigurimi në Slloveni dhe jashtë saj.

ZA & SVET ndërmjetësim në sigurime sh.p.k. nuk ka shoqëri të varura të regjistruara dhe nuk realizon të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

INSURE Invest, shoqëri për investime sh.p.k. është një shoqëri e themeluar në vitin 2024 me qëllim të veçantë për të fituar pjesë në ZA & SVET ndërmjetësim në sigurime sh.p.k.

INSURE Invest shoqëri për investime sh.p.k. nuk ka aktivitete operative në treg

Shoqëria INSURE Invest, shoqëri për investime sh.p.k. nuk ka një shoqëri të varur të regjistruar në Maqedoninë e Veriut dhe nuk gjeneron të ardhura në Maqedoninë e Veriut

Sipas parashtruesve të njoftimit, si tregje relevante për këtë përqendrim mund të konsiderohen: tregu i ndërmjetësuesve të produkteve dhe shërbimeve të sigurimit.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se ky përqendrim mund të bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin komente dhe mendime mbi këtë përqendrim në Komision. Komentet dhe mendimet e palëve të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose në email: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të mbërrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

03.02.2025

Shkup